

Hidromorava KOMPANIA RAJONALE  
PËR UJË DHE KANALIZIM  
HIDROMORAVA Sh.a.  
No 309 Data 05.03.2012  
GJILAN



Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim "Hidromorava" SH.A  
Regionalna Kompanija za Vodovod i Kanalizaciju "Hidromorava" D.D  
Regional Company for Water and Sewerage "Hidromorava" J.S.C  
Gjilan

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit:	KRUMAP	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.:	604
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	20.03.12
PRISHTINË/A			

## Raporti Vjetor për vitin 2011

Mars, 2012

## A. Raporti i Kryesuesit te Bordit te Drejtoreve

### Hyrje

Ky Raport Vjetor , është punuar komform Ligjit Mbi Ndermarrjet Publike , Kodit te Etikes si dhe Udhëzuesit nga Njesia për Politika dhe Monitorim te Ndermarrjeve Publike , si ndihmesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për të gjitha Kompanitë e ujërave në Republikën e Kosovës , në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi në Republikën e Kosovës.

Një prej faktorëve që esencialisht ndikon në performancën dhe zhvillimin efikas të kompanisë është potenciali njerëzor që është resursi më meritues në menaxhimin e veprimtarisë , me plot përgjegjësi në përmbushjen e qëllimit në drejtim të funksionimit të kompanisë.

KRU“Hidromorava” Sh. A ka përgatitur strukturën organizative e cila përputhet me strategjinë zhvillimore sepse rolet dhe përgjegjësit janë të specifikuar mirë. Struktura e përgatitur ka prodhuar efikasitet në perspektivën e menaxhimit të kompanisë.

Prandaj ,gjate vitit 2011 për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe vëllimit të punëve është bërë rekrutimi i dhjetë (10) punonjësve të rinjë , të cilët kanë qenë të nevojshëm për shërbimet përkatëse në kuadër të kompanisë dhe për plotësimin e dy vendeve vakante (për shkak të pensionimit të një punëtori dhe të vdekjes së një punëtori)

Kështu që ,aktualisht KRU“ Hidromorava” Sh.A operon me 151 punëtorë në regjion me njësitë Gjilan 107, Viti 24 dhe Kamenicë 22 punëtorë.I ndarë në shërbimin Administrativ, Financiar dhe Teknik

**KRU“ Hidromorava Sh.A.ka këtë strukturë të të punësuarve :**

Numri i punëtorëve sipas përkatësisë gjinore	Numri i punëtorëve ( femra)	Numri i punëtorëve (meshkuj)	Numri total i punëtorëve
	22	129	151

Nga tabela e mësipërme kuptohet se nga të punësuarit e tërësishëm 85 % janë meshkuj dhe 15% janë femra. Kjo strukture në të ardhmën mendohet që të ndryshohet në të mirë të rritjes së të punësuarve të gjinise femërore.

Numri i punëtorëve sipas pregaditjes shkollore	Numri i punëtorëve me pregaditje superior	Numri i punëtorëve me pregaditje të lartë shkollore	Numri i punëtorëve me pregaditje të mesme shkollore	Numri i punëtorëve më pregaditje të ulët shkollore
	18	6	83	44

Tabela e mësipërme jep strukturën e të punësuarve sipas përgaditjes shkollore. Nga numri i tërësishëm, 12 % e punësuarve kanë përgaditje të lartë superiore, 4 % kane përgaditje të larte shkollore ,55 % përgaditje të mesme shkollore, dhe 29 % e tyre kanë përgaditje të ulët shkollore.

Numri I punëtorëve sipas përkatësisë etnike	Numri I punëtorëve (shqiptar)	Numri I punëtorëve (turq)	Numri I punëtorëve (serb)
	146	2	3

## 1. Aktivitetet dhe performanca e kompanisë

### 1.1. Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit

Me synim të përmbushjes së objektivave dhe politikave zhvillimore të vendosura nga aksionari, për të drejtuar kompaninë drejt suksesit, Bordi i Drejtorëve në mënyrë efikase dhe kolegjiale si ekip në suaza të kornizës ligjore dhe rregullore gjatë vitit 2011, ka përmbushur obligimet ligjore për raportime të rregullta që burojnë nga Ligji mbi Ndermarrjet Publike

**1.1.1. Raportimet tremujore** të vitit 2011, janë aprovuar rregullisht në mbledhjet e bordit të drejtorëve dhe japin shpjegim të aktivitetëve të ndërmarrjes në fushën operacionale, aktivitetet investuese, arritjet e të gjitha departamenteve, njësitëve të biznesit dhe ndryshimet/zhvillimet në strukturën organizative, të dhëna operacionale, transaksionet e rëndësishme, pasqyra financiare tremujore krahasuar me vitin paraprak dhe aktivitetin e zyrës ligjore dhe rastet e padive në gjykatë.

**1.1.2. Raporti vjetor** për vitin 2010 është miratuar më 15. Mars 2011, nga bordi i drejtorëve në përputhje me nenin 31 të LNP, në të cilin janë dhënë përmbledhje të arritjeve operacionale të kompanisë për secilin njësi veçmas

**1.1.3. Plani Biznesit** është miratuar në afatin e paraparë me ligj (31 Tetor) është i mirestrukturuar në bazë të modelit të ofruar nga ZRRUM-I, paraqet objektiva të qarta, dhe është një dokument përmbledhës i përbërë nga tri njësitë e biznesit me argumentimet përkatëse.

**1.1.4. Pasqyrat Financiare** janë miratuar në mbledhjen e bordit të drejtorëve. Raporti i auditorit të jashtëm për Pasqyrat Financiare të vitit 2010 është raport pa rezervë dhe opinion me theksim të qështjes në paraqitjen e gjendjes operacionale dhe financiare të kompanisë. Bordi i Drejtorëve ka rekomanduar ekzekutivitet që të përmbushë rekomandimet e auditorit të jashtëm

**1.1.5. Raporti mbi kënaqshmerinë e konsumatorit** - Në këtë sondazh për kënaqësinë e konsumatorëve janë marrë gjithsej 700 konsumatorë dhe janë përfshirë konsumatorët nga Gjilani, Vitia dhe Kamenica. Gjetjet nga ky hulumtim do të përdoren si udhërrëfyes për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të përmirësuar nivelin e shërbimeve në të cilat adresohen shqetësimet e konsumatorëve në përmirësimin e performancës së imazhit të kompanisë

**1.1.6. Duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit mbi Ndermarrjet Publike**, Bordi i Drejtorëve ka miratuar rregulloret e mbrendshme të kompanisë: Rregulloren mbi krijimin e marrëdhënies së punës, Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore të punëtorëve, Rregulloren mbi kodin e mirësjelljes, Rregulloren mbi kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare, Rregulloren mbi pershkrimin e detyrave të punës, Rregulloren për mbrojtje në punë dhe Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit.

Ne mbledhjet e BD pos shqyrtimit te qeshtjeve qe i takojne komform Ligjit dhe detyrave te caktuara me Statut, jane shqyrtuar edhe qeshtje dhe problematika qe eshte perballur ekzekutivi siq eshte nivelizimi i pagave te punetoreve ne Njesisine e Gjilant e pastaj edhe ne Njesisine e Vitisë pas miratimit të vendimit nga Kuvendi Komunal në Viti për kushtezimin e shërbimeve publike për konsumatorë dhe jemi munduar në gjetjen e rrugëve për të bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet me Kuvendin Komunal në Gjilan,Viti dhe Kamenicë ,Sindikaten, OJQ-të, komunitetet si dhe operatorët ekonomik ,e atë gjithmonë duke e vënë në prioritet interesin e kompanisë për zgjidhjen e problemeve të natyrave të ndryshme komform veprimtarisë së kompanisë.

## 1.2. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

### 1.2.1.Pasqyra operative e kompanisë

	Indikatorët	2010	2011	Trendi	Plani 2011	% e Realiz. të planit
1	Prodhimi I ujit m <sup>3</sup>	7,462,790	7,181,811	neg	8,345,860	86.05
2	UPF m3	4,481,760	4,251,703	Poz	3,674,800	115.70
3	% e UPF	60	59	Poz	55	
4	Numri I kons të regjistruar (total)	18,200	19,110	poz	21,307	89.69
5	Numri I kons me ujmatës	14,699	15,607	poz	19,463	80.19
6	Proporcioni i kons. Me ujmatës %	80.76	81.67	Poz	91.35	89.41
7	Faturimi në €	1,399,474	1,415,161	Poz	1,872,020	75.60
8	Arkëtimi në €	949,170	1,105,165	Poz	1,264,280	87.41
9	Shkalla e arkëtimit %	67.82	78.09	Poz	68	
10	Norma e Mbulimit të Punës	1.31	1.065	neg	1.29	
11	Kostoja për Njësi (€/m <sup>3</sup> )	0.16	0.155	poz	0.15	
12	Efikasiteti I stafit('000 kons)	7.97	7.88	Poz	7.55	
13	Ankesat e kons.	2,584	2,912	neg		
14	Testet e dështuara të kualitetit të ujit	4.6	1.36	poz		

### 1.2.2. Performanca financiare (shpenzimet dhe të hyrat)

	Indikatorët	2010	2011	Plani 2011	% e Realiz.
1	Të hyrat nga arkëtimi	949,206	1,105,164	1,264,280	87.41
2	Të hyrat e tjera	88,586	81,124	156,000	52
3	Totali I të hyrave	1,037,792	1,186,288	1,420,280	84
4	Shpenzimet për paga	611,015	714,878	709,711	100.73
5	Shpenzimet për derivate	29,982	39,184	34,800	112.60
6	Shpenzimet e mirëmbajtjes së rrjetit	50,254	40,166	55,200	71.77
7	Shpenzime e mirëmbajtjes së veturave	15,420	19,621	18,000	108.62
8	Shpenzimet e rrymës	121,127	129,408	120,000	107.84
9	Shpenzimet për kemikale	35,716	26,542	39,600	67.03
10	Shpenzimet për telefoni (fikse dhe mobile)	5,058	6,301	6,000	105.02
11	Shpenzime të tjera	146,932	137,278	248,280	55.29
12	Totali I shpenzimeve	1,015,504	1,113,378	1,231,590	90.40
13	Fitimi (Humbja)	22,288	72,910	188,690	38.62

### 1.3. Komentet-arsyeshmëritë mbi arritjen apo mosarritjen e caqeve nga plani I biznesit

Në tabelën e performancës operative shohim se shumica e indikatorëve të performancës ka trend pozitiv, përveq normës së mbulesës, prodhimit të ujit dhe ankesës së konsumatorëve.

- Arsyja pse është prodhuar ujë më pak është se, është rritur faturimi me ujëmatës.
- Norma e mbulesës është më e vogël, për arsye të rritjes së pagave(diku për 112,000€), edhe përkundër faktit se të hyrat kanë qenë më të mëdha.
- Numri I ankesave të konsumatorëve është rritur për shkak të formës së kushtëzimit për pagesë të ujit, d.mt.th, shumica e ankesave janë për këtë.

Është shumë e rëndësishme, që numri I testeve të dështuara është shumë më I vogël, që do të thotë se kualiteti I ujit ka qenë I mirë.

- Arritja e caqeve sillet diku pre 75% deri në 95%, përveq % së arkëtimin që ka tejkaluar edhe atë të planifikuar.
- Humbjet e ujit edhe pse janë zvogluar për 1%, ende janë shumë të mëdha, është një sfidë që duhet ti përkushtohemi në këtë vit dhe vitet në vijim

#### **1.4. Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e kompanisë**

- a) Aplikimi i kushtëzimit të qytetarëve për disa lloje të shërbimeve (Regjistrim të automjeteve) me pagesën e borxhit ndaj kompanisë së ujit.
- b) Kalimi i Inkasantëve në lexues
- c) Aplikimi i inkasimit nëpër pikat statike
- d) Provizionimi i borgjeve është bërë sipas rekomandimit të auditorit të jashtëm (50%). Vlera e provizionimit të borgjeve për vitin vitin 2011 është 280,511, përderisa në vitin 2010 provizionimi ka qenë 405,731.

#### **1.5. Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm**

- a) Rritja e inkasimit
- b) Zvoglimi i humbjeve të ujit
- c) Rritja e Faturimit
- d) Eliminimi i faturimeve dhe pagesave paushalle
- e) Arritja e caqeve në Planin e Biznesit

## **2. Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën**

Në pasqyrat financiare shihet se edhe përkundër rritjes së rezultatit operativ, para zhvleftësimit, kompania afaron me humbje, kështu që në vitin 2011 kemi zvoglim të kapitalit në vlerë prej 352,553€.

Zhvleftësimi i mjeteve është bërë sipas kategorive, në vlerë prej 5% dhe 20%

### **2.1. Kredite e rendesishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit**

Nuk kemi patur asnjë kredi .

### **2.2. Investimet e rendesishme të bera gjatë vitit**

Përfundimi i ndërtimit të objektit të kompanisë faza e tretë – punët finale , donacion i Qeverisë

### **2.3. Dividendet e paguara gjatë vitit**

Nuk kemi

### 3. Të dhënat për drejtoret jo-ekzekutiv

#### 3.1. Emrat e drejtove te bordit te drejtove, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarjes

Në mbështetje të Nenit 92, paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Nenit 15 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, si dhe të Nenit 4, paragrafi (3) të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës pas një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, ekskluzivisht në bazë të meritave, për KRU "Hidromorava" Sh.A.-Gjilan më datë 24.12.2008 merr vendimin nr. 17/48 mbi formimin e Bordit të Drejtorëve në këtë përberje :

1. Z. Avdyl Hasani, Kryesues I Bordit te Drejtove
2. Znj Elhame Shefkiu, Kryesues I Komiteti te Auditimit
3. Z. Azem Mujku ,Anetar I Bordit te Drejtove
4. Z. Xhelal Selmani ,Anetar I Bordit te Drejtove

Në KRU "Hidromorava"SH.A kompensimet për Drejtorët, që nga fillimi i konstituimit të BD e deri me raportimin , është bërë Komfor Vendimit Nr.07/56 datë: 18.02.2009 - Mbi lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndermarrjeve publike qendrore sipas kategorizimit të vendosur nga Akcionari- Qeveria e Kosoves .

Nr.	Emri e Mbiemri	Pozita	Skema e kompensimit	
			BD	KA
1.	Avdyl Hasani	Kryesues I Bordit te Drejtove	320 €	
2.	Elhame Shefkiu	Kryesues I Komiteti te Auditimit	270 €	120 €
3.	Azem Mujku	Anetar I Bordit te Drejtove	270 €	100 €
4.	Xhelal Selmani	Anetar I Bordit te Drejtove	270 €	100 €

#### 3.2. Numrin e takimeve te bordit gjate vitit dhe numrin e pjesemarrjes se drejtove ne takimet e bordit

Me synim të përmbushjes së misionit të tij dhe kryerjes së detyrave të tij në mënyrë sa më efektive ,Bordi i Drejtorëve,gjatë kësaj periudhe ka mbajtur dhjetë (10) mbledhje ,prej të cilave nëntë (9) të rregullta dhe një (1) e jashtëzakonshme dhe pjesemarrja e drejtove ne takimet e bordit ka qene e rregullt.

Gjatë secilës mbledhje janë rishikuar dhe diskutuar performancat financiare dhe operative të kompanisë ,implementimin e planit të biznesit ,planin e investimeve dhe raportet e ZKE-së për transaksionet kryesore ,vendimet dhe ngjarjet e periudhes përkatëse.

Vendimmarrja në Bord gjithmonë është bërë në mënyrë demokratike dhe të lirë duke e respektuar të drejten e lirë dhe pa presione të votimit dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

Gjithmonë, në kontest të përmbushjes së misionit ,përmes sekretarit të kompanisë ,kopjet e procesverbaleve nga takimet ,raportet ,dokumentet përkatëse dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve janë përcjellë me rregull në NJPMNP në MZHE.

### **3.3. Komitetet e bordit, perberjen e tyre dhe numrin e takimeve te mbajtura**

Në mbështetje të Nenit 24 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, Qeveria e Kosovë për KRU "Hidromorava" Sh.A.-Gjilan më datë 24.12.2008 merr vendimin nr. 17/48 mbi formimin e Komitetit të Auditimit në kuadër të Bordit të Drejtorëve në përbërje prej:

- Znj.Elhame Shefkiu ,Kryesuese e KA
- z.Azem Mujku ,anetar i KA
- z.Xhelal Selmani ,anetar i KA

Bordi I Drejtorëve në KRU" Hidromorava" ka funksional vetem komitetin e auditimit dhe gjatë këtij viti jane mbajtur 6 (gjashtë) mbledhje , gjatë të cilave janë shqyrtuar qështje thelbësore të afarizmit të kompanisë para shqyrtimit dhe miratimit në Bord të drejtorëve .Ndërsa komitete të tjera nuk janë themeluar për shkak se Bordi I Drejtorëve nuk e ka parë të nevojshme.

## **4. Informacione te tjera**

### **4.1.Nje permbledhje e te gjitha procedurave gjyqesore që janë zhvilluar gjatë vitit 2011**

4.1.1. **Kontesti me Moravën e Binçës-** Pasi që me datë 21.10.2010, kemi parashtruar ankesë drejtuar Gjykatës Supreme Dhoma e Posaqme në Prishtinë rreth aktgjykimit me nr.Cnr.77606, me të cilin refuzohet kërkesa e KRU" Hidromorava" Sh.A. për vërtetimin e pronësisë të ngastrës kadastrale nr.2136/18 në sip.0.02.06ha,ku ndodhet objekti I administratës Më datë 26.Prill .2011, na është kthyer përgjigjja e kërkesës sonë e drejtuar në Drejtorinë për Kadastër , Gjeodezi ,Pronë dhe Banim me numër 598 e datës 15.09.2010, lidhur me konkluzën nr.K 951-1999/2009 (12537) sipas të cilës është aprovuar kërkesa e NHNI"Morava e Binçës" për përmirësimin e tutullarit të pronës sipas fletës poseduese nr.2597 prej P.SH " Vodna Zajednica" në OSH" Morava e Binçës" .Në bazë të përgjigjes nga DKGJPB thuhet që kjo drejtori përkatësisht sektori I kadastrit perms konkluzës nr.K-951-1999/2008, të datës 30.12.2008, vetëm ka bërë rindërtimin e informacioneve kadastrale Më datë 03.Maj 2011, nga Gjykata Supreme e Kosovës na është dërguar Reagimi në Ankesën tonë të dërguar më 21.10.2010,nga ana e Agjensionit Kosovar të Privatizimit në emër të NSh. Morava e Binçës , me të cilën ka kundërshtuar ankesën e KRU" Hidromorava" si të pa bazuar në ligj.Më datë 11.Maj 2011, kemi parashtruar ankesë në DGJKPB në Gjilan kundër përgjigjes në Kërkesë me nr.SH.Z.nr.12/100/2010 e datës 26.04.2011, e Drejtorisë për Gjeodezi ,Kadastër, Pronë dhe Banim për rishqyrtimin e Konkluzës nr.K-951-1999/2008 të datës 30.12.2008.Më datë 16.Maj .2011 kemi parashtruar përgjigje me nr.737 ndaj mbrojtjes SCA-11-0038, dretjuar Gjykatës Supreme –Dhomës së Posaqme në Prishtinë me të cilin rast kemi kërkuar , që të aprovohet ankesa jonë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.776/06 të datë 5 Gusht 2010.Që gjykata supreme të vendosë mundësisht lidhur me qështjen e kontestit dhe të aprovojë kërkesëpadinë tonë , se jemi shfrytëzues të përhershëm të pronës shoqërore parcelës 2136/18, nëndarja e tretë me sipërfaqe prej 00.02.06 ha, ZK Gjilan fleta poseduese 2598, nese e njejta gjykatë nuk do të vendosë rreth kësaj lëndë me vendim meritor atëherë lënda C.nr.776/06 ose thënë aktgjykimi I saj të priset dhe të shpallet nule dhe lënda t'i kthehet të njejtës gjykatë në rigjykim dhe ankesa e AKP-së e datës 21.Prill 2011 lidhur me lëndën SCA-11-0038 ta hudhë poshtë në tërrësi si të pa bazë



**4.1.2. Kontesti me Korporatën Enerxhetike të Kosovës –Njësia Gjilan** - Kompania jonë ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjilan ,kundër Korporatës Enerxhetike të Kosovës për kompenzimim e dëmit në vlerë prej 10.000 € më datë 04.Prill 2006.Mirëpo Gjykata Komunale në Gjilan pas shqyrtimit të lëndës ka ardhur në perfundim se nuk është kompetente për të vepruar më tej sipas kësaj lëndë dhe të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë si gjykatë kompetente . Më datë 22.Qershor 2011, është lëshuar thirrja nga Gjykata Ekonomike në Prishtinë për senacën për shqyrtimin kryesor kundër paditësit KEK Njësia në Gjilan që është mbajtur më datë 11.Korrik 2011. Gjithashtu, më datë 08.Shtator 2011, është mbajtur seanca e dyte dhe më datë 07.Tetor 2011, nga Gjykata Ekonomike në Prishtinë është lëshuar Aktgjykimi më të cilin rast Refuzohet kërkesëpadia e KRU" Hidromorava" Sh.A. , me të cilën është kërkuar që të Obligohet i padituri Korporata Energjetike e Kosovës Njësia në Gjilan , që paditësit t'ia paguajë në emër të kompenzimit të dëmit , shumën prej 10.000€, si dhe të paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore

**4.1.3. Kontesti me NSH Kosovatrans** Më datë 10.Qershor 2011, Gjykata Komunale në Gjilan ka lëshuar Aktvendim C.nr.363/2011, lidhur me caktimin e masës së përkohëshme e propozuar nga paditësi NSH Kosovatrans në Gjilan ,me të cilën masë urdhërohet Hidromorava që paditësit menjëherë t'ia lëshojë ujin dhe ta kyqin në rrjetin e ujësjellësit në shfrytëzim të pandërprerë ,gjer në përfundimin e kontestit Më datë 14.Qeshor 2011, kemi parashtruar Kalëxim penal PP-1354/2011 kundër NSH.Kosovatrans Gjilan me shifër 410011 sepse ka bërë dëmtimin e bllobës dhe është rikyqur në mënyrë ilegale në rrjetin e ujësjellësit , me qëllim të shmangjes së pagesës si dhe të keqpërdorimit të ujit , me të cilin rast ka bërë shkelje të dispozitave të Rregullatorit të lëshuar nga ZRRUM –I dhe ka kryer vepër penale sipas dispozitave të KPPK –sëMë 22.Qershor .2011, nga Gjykata Komunale në Gjilan është dërguar padia e ngritur nga NSH.Kosovatrans në Gjilan me të cilën është kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit NSHKosovatrans dhe të obligohet e paditura KRU" Hidromorava në Gjilan që paditësit t'ia kyqë ujëmatësin dhe t'ia kompenzojë shpenzimet e kontestit të gjitha këto në afat sa më të shkurtër duke I marrë parasysh rrethanat ekzistuese nën kërcënim të ekzekutimit më dhunë

**4.1.4. Kontesti me QT Agmia** Më datë 26.Janar 2011, në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë është mbajtur seanca përfundimtare me Qendrën Tregtare "Agmia' ndaj të cilit kemi parashtruar Propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm për shpenzimet e ujit dhe të kanalizimit nr.670 më datë 18.Tetor 2010 ,kontest I cili kap shumën prej 14.496.43 €.Dhe më datë 19.Maj .2011 e kemi pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë lidhur me aprovimin e pjesërishtëm të kërkesëpadiisë të KRU" Hidromorava" dhe që obligohet I padituri Qendra Tregtare Agmia në Gjilan që Hidromoravës t'ia paguajë në emër të borxhit kryesor shumën prej 12.113.99 €,me 3.5% kamatë vjetore ,duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë më 18 Tetor 2010, gjerë në pagesën definitive të borxhit si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 144.€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh ,nga dita e pranimit të aktgjykimit ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .Dhe më datë 20.06.2011, është arritur marrëveshja për shlyerjen e obligimeve ne bazë të aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Ekonomike në Prishtinë në mes të kompanisë dhe QT Agmia dhe pagesa është kryer dhe rasti është I përfunduar .

#### **Kontestet me punetorë :**

**4.1.5. Kontest me ish punëtorin Raif Kasumit** Me rastin e largimit nga marrëdhënia e punës së punëtorit Raif Kasumi për shkak të keqpërdorimit të mjeteve financiare .Më 18 Shkurt 2011, kemi parashtruar padi për kthim të mjeteve të marra në Kompani , ndaj ish punëtorit Raif Kasumi ,me kërkesën që të aprovohet padia dhe që të obligohet z.Raif Kasumi të bëjë pagesën në shumë prej 5.384.16 € në arkën e Kompanisë me kamatë ligjore që paguan banka për mjetet e deponuara pa destinim në kohëzgjatje vjetore duke llogaritur kamatën mujore që nga dita e ushtrimit të padisë deri në ditën e ekzekutimit si dhe shpenzimet procedurale

4.1.6. **Kontesti me Xhelal Shabanin** Gjykata Komunale në Gjilan, me aktgjykimin C.nr.275/2009 të datës 25 Shkurt 2011, ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit z.Xhelal Shabani nga Gjilani, të paraqitur kundër KRU "Hidromorava Sh.A. nga Gjilani dhe e ka detyruar kompaninë ,që z.Xhelal Shabanit t'ia kompenzojë të ardhurat personale në shumën prej 17.379,21 €, me kamatë bankare prej 3.5% ,duke filluar pre 03 Shtator 2010 deri në pagesën definitive,në emër të kompenzimit të të ardhurave personale për kohën nga ndërprerja e marrëdhënies të punës nga e ana e të paditurit më 04 Mars 2006 deri më 22 Mars 2010, kur z.Xhelal Shabani është kthyer në punë në vendin e punës Menaxher Financiar.Dhe e ka detyruar kompaninë gjithashtu që z.Xhelal Shabanit t'ia kompenzojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 655 €, e atë në emër të pesë përfaqësimeve nga 101 € dhe në emër të ekspertizës , shumën prej 150 € ,të gjitha këto nën kanosjen e përmbarimit të dhunshëm. Aktgjykimin nga Gjykata e shkallës së parë C.nr.275/2009 të datës 25 Shkurt 2011, e kemi pranuar më datë 08 Mars 2011, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Rev.nr.45/2008 të datës 16 Janar 2011, e kemi pranuar më 11 Mars 2011,çka do të thotë ,i njëjti aktvendim është pranuar në afatin derisa ka zgatur e drejta për ankesë. Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë me aktvendimin Rev.nr.45/2008 të datës 16 Janar 2011, ka vendosur që të Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.681/2006, e datës 12.Qershor 2007 dhe i Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.353/2007, i datës 26.Tetor 2007, në pjesën që ka të bëjë me anulimin e konkursit të paditurit, të publikuar në të përditëshmen "Koha Ditore" më datë 01.Shkurt 2006, për vendin e punës.Menaxher Financiar dhe padia e paditësit hidhet poshtë dhe Priset aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.681/2006 e datës 12.Qershor 2007 dhe i Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.353/2007 i datës 26.Tetor 2007, në pjesën që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të paditurit nr.703 datë 04.Mars 2006, mbi largimin e paditësit nga marrëdhënia e punës dhe kthimin e paditësit në vendin e punës Menaxher Financiar dhe lënda i kthehet gjykatës të shkallës së parë në rigjykim .Prandaj është pregaditur ankesa e cila i është drejtuar Gjykatës me kërkesën që të Aprovohet ankesa e KRU"Hidromorava" Sh.A.nga Gjilani dhe të priset aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.275/2009 i datës 25 Shkurt 2011 dhe lënda t'i kthehet të njëjtës Gjykatë në rigjykim.Më datë 19.Dhjetor 2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan ,duke vendosur sipas ankesës së KRU"Hidromorava" Sh.A. të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.275/09 të dt. 25.02.2011, ka lëshuar Aktvendim me të cilin Pranohet ankesa e KRU" Hidromorava" Sh.A. në Gjilan dhe Priset Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rivendosije .

4.1.7. **Kontesti me ish punëtorin Agim Hajrullahu** Më datë 01.Gusht.2011, nga Gjykata e Qarkut në Gjilan kemi pranuar Aktvendim per lenden AC nr.262/10 me te cilin Refuzohet si e pabazuar ankesa e KRU" Hidromorava" kunder te paditurit Agim Hajrullahu ish punëtor, per kthim te mjeteve ne vlere 2.637.05 € Më datë 02.Gusht 2011, është paraqitur në Prokurorinë Shtetërore të Republikës së Kosovës në Prishtinë , kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan AC nr.262/10, Më datë 08.Gusht 2011, është dërguar shkresa nga Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kosovës në Prishtinë ,për dërgim të parashtresës me provë të datës 11.Maj .2010Më datë 09.Gusht 2011, i është dërguar parashtresa me dëshminë e kërkuar ,Prokurorisë Shtetërore të Republikës së Kosovës në Prishtinë Më datë 15.Gusht 2011, nga Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kosovës në Prishtinë , kemi pranuar njoftimin që Prokuroria nuk ka gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit AC. Nr. 262/10 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan .

#### **4.2.Një përshkrim I procedurave gjyqësore që pritet të inicohen gjate vitit aktual;**

Si qështje me e rëndesishme dhe e ndjeshme eshte kontesti që e kemi me NN" Morava e Binçës" dhe që i njëjti është në fazën e privatizimit , lidhur me pjesën e parcelës 2136-18 në sipërfaqe prej 2.06 ha me kulture shtëpi – ndërtesë, të cilën jemi duke e shfrytëzuar prej vitit 1978 dhe rasti tani ndodhet në procedurë ankimi në DHPGJSK me numrin referues SCA -11-0038.

Gjithashtu edhe vazhdimi I procedurave të cilat janë në procedim te mëtutjeshem ne gjykatë si dhe rastet evetuale që mund te paraqiten dhe që mund te inicohen brenda vitit aktual 2012.

5. *Transakcionet e konsiderueshme gjate vitit 2011*

Nr.	Emri I kompanis	Pagesa	Obligimi	Salldo
1	Ada gas	43460.6	44009.98	549.38
2	Berisha kompani	1371	964	-407
3	Cufa comer (Viti)	3300	3700	400
4	Duli trade	5402	5597	195
5	Era med	1256.5	1367	110.5
6	Fatoni	5625.4	16719.6	11094.2
7	Auto servisi Genti	8385.5	8630.5	245
8	Hidrotech	1850	870	-980
9	Hidroterm	2641.68	2226.06	-415.62
10	Instituti regjional I shendetsis	4970	8520	3550
11	Instituti regjional I shen.Kam	1380	1656	276
12	Instituti regjional I shen.Viti	1430	1716	286
13	Linda	5561.25	5153.63	-407.62
14	Mentori Deqan	9911.91	9911.91	0
15	Metal monti	1114.6	1150	35.4
16	Pika 5a	4317.28	4980.89	663.61
17	Proneti	6834	6484	-350
18	Seykos	17456	19932.1	2476.1
19	Shukos	5390	3726	-1664
20	Auto servisi te agimi	4969	5239	270
21	Toni Impex	4324	4227.65	-96.35
22	Trend bizi	2159.92	2159.92	0
23	Trepca	30397	12221.59	-18175.41
24	Uka as	1807.3	1815.25	7.95
25	Vala	3200.95	3505.95	305
26	Zejna Pozh.	4490.2	4490	-0.2
27	Zrrumi	13673.94	13784.28	110.34
28	Keku	172167.13	150109.89	-22057.24
	Total			-23978.96

## 6. Raportet e zyrtarit te Auditimit te Brendshem

Bordi i Drejtorëve gjatë punës së tij ka konstatuar se në kuadër të organizimit të përgjithshëm të kompanisë është jashtëzakonisht e rëndësishme mes të tjerave të punohet në evidentimin e menaxhimit të rrezikut përmes punës së Auditorëve të jashtëm dhe të brendshëm,

Bordi i Drejtorëve përmes Komisionit të Auditimit ka arritur të siguroj efikasitetin e kontrollit të brendshëm përmes e programit të punës për Auditimin e brendshëm, sipas kësaj ecurie është konstatuar shkalla e rrezikshmërisë dhe gjetja e rreziqeve kryesore në biznesin e kompanisë, janë dhënë rekomandimet në lidhje me eliminimin e gjetjeve të paraqitura në raportet e rregullta të auditorit të brendshëm

Është dhënë raport për gjendjen vjetore 2011 të punës së zyrtarit të auditorit të Brendshëm në përbërje ;

1. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të ZAB nga KE-gjegjësisht zyrtarët e autorizuar
2. Raporti i Auditimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit për muajin 10 / 2010
3. Kriteret për shpalljen e tenderit për Auditim të jashtëm të Pasqyrave Finansiare
4. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të ZAB nga KE-gjegjësisht zyrtarët e autorizuar – korigjimet e prezantuar në pyetësorin e datës 24.12.2010 nga zyrtari i Prokurimit dhe zyrtarja e Resurseve Humane
5. Raporti final i Auditimit të librit të protokollit-Gjilan Prej 01.01-15.02.2011
6. Raporti final i Auditimit të vijueshmërisë (ardhje-vajtje)të punëtorëve në punë,daljet nga puna të punëtorëve gjatë orarit të punës për muajin shkurt –mars 2011.
7. Ndryshimet e Planit Vjetor të Auditimit të brendshëm -2011
8. Raport i Auditimit mbi ligjshmërin e realizimit të projektit -Ndërtimi i Objektit Administrativ –faza e dytë (punët finale) -situacioni i tretë sipas punëve të kryera

Tre Draft raporte të auditimit –menaxhimi i arkës njësie në Gjilan ,Viti dhe në Kamenicë nga : 01.01.2011-29.07.2011

9. Raport final i auditimit – menaxhimi i arkës njësie në Gjilan 01.01.2011- 29.07.2011
10. Raporti final i auditimit – menaxhimi i arkës njësie në Viti 01.01.2011-29.07.2011
11. Raporti final i auditimit – menaxhimi i arkës njësie në Kamenicë 01.01.2011- 29.07.2011
12. Raport i Auditimit mbi ligjshmërin e realizimit të projektit -Ndërtimi i Objektit Administrativ –faza e dytë (punët finale)-punët shtesë sipas faturës 05/2011 të 02.09.2011
13. Draft raporti i auditimit – shpenzimet për mallëra dhe shërbime për të tri njësitë operative(Gjilan,Kamenic,Viti 01.01.2011-30.11.2011

## B. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

Raporti i zyrtarit kryesor ekzekutiv nderlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të korporatës.

### I. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

#### 1.1. Arritjet kryesore

##### 1.1.1. Bashkëpunimi i Kompanisë me Pushtetin Lokal dhe aplikimi I sistemit të inkasimit përmes formës së kushtëzimit komunal

Me qëllim të zvoglimit të kërkesave të pa inkasuara nga konsumatorët, Kompania "Hidromorava" sh.a. iu ka drejtuar për ndihmë dhe bashkëpunim organeve të pushtetit lokal të Komunave Gjilan, Viti, Kamenicë, që të shiqohet mundësia e zgjidhjes së problemit të inkasimit.

Paraprakisht, kompania ka marrë nga ZRRUM-i aprovimin e kërkesës së kompanisë, për mundësinë e aplikimit të formës së kushtëzimit të qytetarëve për disa lloje të shërbimeve ( Regjistrim të automjeteve) me pagesën e borxhit ndaj kompanisë së ujit.

Organet e Pushtetit Lokal të Komunave Gjilan e Viti, pa hezitim iu kanë përgjigjur pozitivisht bashkëpunimit, dhe kanë aplikua këtë formë të ofrimit të ndihmës në inkasim të borxheve të papaguara të konsumatorëve. Ky bashkëpunim është më I zbehtë në Komunën e Kamenicës, ku momentalisht kjo formë e kushtëzimit të pagesës së ujit nuk është aplikua.

Kontaktet me Organet e pushtetit lokal të Kamenicës vazhdojnë ende dhe shpresojm (edhe pse me dyshim) se do gjejm gjuhë të përbashkët bashkëpunimi.

##### 1.1.2. Shtimi I numrit të konsumatoreve dhe instalimi I ujëmatësve te konsumatorët me paushall

Si rezultat I kushtëzimit te konsumatoreve nga Komuna janë zbuluar dhe identifikuar afro 300 konsumatorë të rinje te cilet kane qene konsumatore ilegal si dhe Jane regjistrua edhe 700 konsumatore te rinje dhe tek të gjithë janë instaluar ujëmatësit.

#### 1.2. Çeshtjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit.

##### 1.2.1. Synimi për marrjen në menaxhim të sistemeve të ujësjellësve rural, dhe sistemeve të ujësjellësve të Komunave të reja.

Janë disa lokalitete rurale të Regjionit të Gjilanit, të cilat me anë të Donacioneve të jashtme dhe Granteve lokale kanë arritë të ndërtojnë sisteme ujësjellësi, si: fshati Pasjan, Topanicë, Karaçevë, Pozharan, Zhiti, Skifteraj, Kufcë e epërme, Kmetovc, Zhegra, Budrika, Nasala dhe Lladova.

Janë bërë takime me organet e pushtetit lokal të këtyre fshatrave, me donatorët dhe kryesit e punëve si dhe janë inspektua këto sisteme në vend të ndodhjes, e gjitha këto me qëllim të pasqyrimin më të saktë të gjendjes së tyre dhe shqyrtimit të mundësive të marrjes së tyre në menaxhim.

Gjetjet më të theksuara të dala nga këto aktivitete kanë të bëjnë me: humbjet e mëdha të ujit në rrjetet e këtyre sistemeve, materjali i dobët dhe jo standard i sistemit të gypave, kyqjet individuale të bëra me material të dobët, mos kyqja e plotë e konsumatorëve individual, borxhet e mëdha të rrymës ndaj KEKut e sistemeve funksionale të ujësjellësve rural.

Nga diskutimet e Menaxhmentit të kompanisë "Hidromorava" sh.a. me akterët relevant të kësaj qështje (të cekur më lartë), lidhur me qështjen e kyçjes së sistemeve të ujësjellësve rural nën menaxhimin e "Hidromoravës" nxiren përfundime se, sistemet rurale të ujësjellësve më pare do duhej ti evitojn defektet e cekura në sistem, të gjindet forma e shlyrjes së obligimeve të rrymës ndaj KEKut, të instalohen ujematesit të gjithë konsumatorët e pastaj këto të mirren nën menaxhimin e "Hidromoravës" meqë në gjendjen e tashme të tyre "Hidromorava" e ka shumë vështirë ti marr në menaxhim.

Për të funksionua më mire ndërtimi i sistemeve të ardhshme rurale dhe kyqja e tyre nën menaxhimin e "Hidromoravës" do duhej një koordinim më funksional mes Donatorëve, Pushtetit lokal dhe Kompanisë.

Qështje po aq me rëndësi në funksionalizimin e sistemit të ujësjellit në Regjionin e Gjilanit është edhe kyqja e sistemit të ujësjellësve të komunave të reja (Klllokot, Partesh, Ranilluk, Novobërdë) nën menaxhimin e kompanisë "Hidromorava".

Lidhur me këtë qështje, në bashkpunim me NJPMNP, është vendosur që të formohet një komision i përbërë nga një përfaqësues i kompanisë "Hidromorava" dhe nga drejtorët e shërbimeve publike të këtyre komunave, dhe të bëhet vlerësimi i gjendjes egzistuese të këtyre sistemeve, dhe tu dërgohet një raport NJPMNP në mënyrë që kjo pastaj ta prezantoj atë tek donatori Zvicran për ndihmë në riaftësimin e këtyre sistemeve.

### **1.2.2. Realizimi i projekt donacioneve dhe kontaktet me Donatorët**

Edhe gjat 2011, Qeveria Zvicrane mbetet mbështetësi kryesorë i zhvillimit të sistemit të ujësjellësit në Regjionin e Gjilanit.

Në rrjedhë e sipër është implementimi i projektit të fazes së katërtë të Qeverisë Zvicrane, që ka të bëjë me:

- (i) investimet në sistemet e ujësjellësve në viset rurale dhe menaxhimi i tyre, dhe
- (ii) përkrahjen institucionale në përmirësimin e shkallës së inkasimit, zvoglimit të humbjeve dhe i shpenzimeve operative.

Përfituesit nga ky projekt gjat vitit 2012 do të jënë:

- a. Ujësjellësi në Bresalc dhe Ponesh në vlerë prej 600.000,00€, dhe
- b. fabrika për trajtimin e ujrave të zeza në Pogradjë në vlerë 400.000,00€

Në kontaktet me donatorët dhe implementuesit e projekteve, "Hidromorava" sh.a. ka cekë rëndësinë e kontrollit dhe mbikqyrjes së punëve ekzekutuese të projekteve, meqë shpesh puna dhe materialet e përdorura po janë jo cilësore dhe nuk po i përgjigjen standardeve, kështuqë këto po krijojnë barrë të pa përballueshme për marrjen e këtyre sistemeve nën menaxhim.

Janë zhvilluar disa kontakte me përfaqësuesit e IPA-s, Komisionit Europian, të cilët janë duke mbledhur të dhëna për hartimin e një Master Plani për trajtimin e ujrave të zeza në pellgun e Moravës Perëndimore, plan ky me interes për Regjionin.

### **1.2.3. Bashkëpunimi ndër rajonal I Shoqatave të ujit të Ballkanit përdimorë**

Me qëllim të këmbimit të përvojave dhe gjetjes së mënyrës së bashkëpunimit, janë organizua dhe kemi mbajtur takime në Mal të Zi e Shqipëri me Shoqatat e Ujit të Ballkanit Përdimorë.

### **1.2.4. Instalimi I ujëmatësave digjital**

Kompania "Hidromorava" sh.a. ka shqyrtua mundësinë e instalimit të ujëmatësave digjital, leximi I të cilëve bëhet në mënyrë kompjuterike duke mos patur nevojë të bëhet shiqimi fizik I tyre. Është vendosur që të provohet me një pilot projekt. Po studjohet mundësia e instalimit të afro 50 ujëmatësve të këti lloji në një qëndër banimi kolektiv. Nga furnizuesi N.T.P. "Mentor" është kërkuar të na ofrohet oferta për këtë qëllim.

### **1.2.5. Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Kadastrit të objekteve nëntokësore**

Në bashkëpunim me Ndërmarjet e tjera Publike në Regjion (KEK, PTK, Higjiëna), po shqyrtohet mundësia e krijimit dhe të mirëmbajtjes së Kadastrit të objekteve nëntokësore.

### **1.2.6. Porto arkat**

Me qëllim që shërbimi të jetë sa më afër konsumatorit, Kompania ka hapë 4 porto arka në kater lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve. Keto arka jane si politike e kompanise qe ne vitin 2012 te I largon inkasantet nga terreni dhe te nderpres pagesen dore me dore. Kjo eshte edhe nje forme e shfrytimit sa me racional te punetoreve ne leximine ujematesve dhe te evitohet mundesia e keqperdorimi te parase.

### **1.2.7. Aktivitetet tjera operative**

Me qëllim të redukimit të numrit të kyçjeve ilegale, kyçjeve të dyfishta, konsumatorëve fiktiv, gjat tërë vitë janë angazhuar ekipe mobile për verifikim të gjendjes në teren. Veprimet e tilla kanë efektin e dyfishtë në: korigjimin e shënimeve bazë, dhe në uljen e humbjeve administrative/komerciale.

### **1.2.8. Nivelizimi i pagave**

Vendimi për nivelizimin e pagave është marrë nga Bordi I Drejtorëve. Lidhur me këtë qështje Bordi dhe Menaxhmenti I kompanisë ka qënë nën presion, posaqërisht nga punëtorët e Njesisë së Viti-së.


## **2. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE DHE REZULTATET E NDIKATORËVE KYÇ TË PERFORMANCËS**

### **2.1. Niveli i shërbimeve të ndërmarrjes - indikatorët fizik .**

Gjatë vitit 2011, prodhimi i ujit është realizuar në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për ujë. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur reduktime të rregullta të ujit, përpos një periudhe 2-3 javore gjatë muajit Gusht, kur piku i harxhimit të ujit ishte i madh.

Në vijim, paraqitja tabelare tregon prodhimin e ujit/m<sup>3</sup>, të realizuar gjatë vitit 2011 sipas Njësive Punuese.

Viti 2011	Janar	Shkurt	Mars	Prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	Dhjetor	Totali m3
Gjilani	531390	481561	527604	498427	536014	550091	542178	543553	566875	549382	456678	477349	6.261.102
Kamenica	40189	39113	44268	41983	45292	44421	42360	52491	44507	43348	36415	39714	514.101
Vitia	33868	33796	33434	32989	33172	34013	33813	32742	34038	35145	35296	34302	406.608
<b>TOTALI:</b>	<b>605447</b>	<b>554470</b>	<b>605306</b>	<b>573399</b>	<b>614478</b>	<b>628525</b>	<b>618351</b>	<b>628786</b>	<b>645420</b>	<b>627875</b>	<b>528389</b>	<b>551365</b>	<b>7.181.811</b>



Gjatë vitit 2011 janë prodhuar gjithsejtë 7.181.811 m<sup>3</sup> ujë.

Nga kjo sasi e ujit të prodhuar, sasia e ujit të faturuar është 2.932.699 m<sup>3</sup> ujë. Arsyet kryesore të humbjeve të ujit janë: rrjeti i amortizuar i gypave, defektet e shpeshta në rrjetin e ujësjellësit, numri i lartë i konsumatorëve pa ujëmatës, lexim jo i rregullt i ujëmatësve, keqpërdorimet në rrjet, kyçjet e dyfishta në rrjet dhe kyçje ilegale etj. Ne konsiderojmë se totali i humbjeve të ujit mund ti takojë: 50%- humbjeve teknike dhe 50% humbjeve administrative.

Me qëllim që të ulet shkalla e lartë e ujit të pafaturuar dhe njëherit të rritet performanca e përgjithshme e kompanisë, KRU Hidromorava ka planifikuar që, nga muaji Shkurt '2012 të fillojë me një strategji të leximit të ujëmatësve dhe të menaxhimit të zonave, përmes specialistëve dhe angazhimit të inkasantëve që do të vendosen për secilën zonë.


Zona e shërbimit është ndarë në 16 zona me nga ` 800-1000 konsumatorë. Secila zonë do ti ketë kufijtë e vet të qarta, kategoritë dhe numrin e saktë të konsumatorëve.

Kualiteti i ujit të prodhuar gjatë vitit 2011 në përgjithësi i ka përmbushë standardet e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Sipas raporteve të pranuar nga Instituti i Shëndetit publik i cili bënë kontrollin e kualitetit të ujit, shihet se ka pasë disa dështime të kualitetit të ujit, por numri i tyre në krahasim me mostrat e marrura në total është i vogël. Kryesisht dështimet kanë qenë nga vështësitë në furnizim me klor (të importuar nga Serbia) dhe në disa raste nga amortizimi i paisjeve të dezinfektimit.



Tabela e kontrollit të kualitetit të ujit.

Viti 2011	janar	Shkurt	Mars	prill	maj	qeshor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	Dhjetor	Totali
<b>Numri total i mostrave</b>	105	120	149	149	149	149	149	149	149	140	136	149	<b>1.693</b>
<b>Deshtimet ne rrjet</b>	0	0	0	0	0	0	8	7	4	0	0	4	<b>23</b>
<b>Perqindja</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	5.37	4.70	2.68	0.00	0.00	2.68	<b>1.36</b>




Shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit ka vepruar përmes dy ekipeve, njeri i angazhuar në zhbllokimin e tubacioneve të kanalizimit, ndërsa ekipi tjetër për pastrimin e pusetave.

- Janë zhbllokuar 1202 pusetat në gjithë zonën e shërbimit .
- Janë vendos mbi 30 kapakë në pusetat e kanalizimit, 6 nga këto me peshë të rënda, në pjesë të ndryshme të qytetit.

**2.2.Ndryshimet që kanë ndodhur në performancë operative në krahasim me vitin e kaluar dhe me caqet e planit te biznesit.**

	Realizuar 2010	Planifikuar 2011	Realizuar 2011	2011R/2010R	2011R/2011P
Prodhimi I ujit m3	7,462,790	7,543,000	<b>7,181,811</b>	96.23 %	95.21%
Faturimi I ujit m3	2,979,490	3.399.000	<b>2,930,109</b>	98.34 %	86.21%
Uji I pafaturuar m3	4.483.300	4.144.000	<b>4.251.702</b>	94.83 %	102.6 %
Uji pafaturuar %	60.07	55	<b>59</b>		
Uji I faturuar %	39.93	45	<b>41</b>		



*Nga tabela shifet se uji I faturuar gjat vitit 2011 ka qenë më i lartë se i vitit paraparak 41% me 40%, gjegjësisht uji I pafaturuar në vitin 2011 ka qenë 59%, ndërsa gjat vitit 2010 ka qenë 60%. Ky zvoglim I përqindjes së ujit të pa faturuar në vitin 2011 krahasuar me atë të vitit 2010 është rezultat I legalizimit te konsumatoreve ilegal.*

*Uji I pafaturuar I planifikuar 55% për vitin 2011, nuk është aritë të realizohet për 4% , edhe përkundër përpjekjeve të bëra duke legalizua kyçjet ilegale, duke organizue fushata kontrollash, duke u mundua me I evitu rrjedhjet me kohë, shifet se duhet angazhime të vazhdueshme për zvoglimin e kësaj brengje të kompanisë.*

### 3. PASQYRAT E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

#### 3.1. Pasqyrat e Konsoliduara Financiare janë në përputhshmeri me standardet nderkombetare të kontabilitetit.

##### a. Pasqyren e humbjeve apo fitimit

		PASQYRA E TE ARDHURAVE	Periudha paraprake	Periudha raportuse
			2010	2011
TË HYRAT NGA SHITJA E UJIT			1,399,076.97	1,415,160.76
TË HYRAT NGA SHËRBIMET			160,949.59	141,692.87
TË HYRA FINANCIARE (KAMATA)			-	776.74
<b>TOTAL TE HYRAT NGA SHITJEDHE SHERBIMET</b>			<b>1,560,026.56</b>	<b>1,557,630.37</b>
TË HYRAT NGA GRANDET			139,227.76	141,182.05
TË HYRAT NGA SUBVENCIONET			20,086.40	16,880.00
<b>TOTAL TE HYRAT(grandet dhe subvencionet)</b>			<b>159,314.16</b>	<b>158,062.05</b>
<b>TOTALI I TE HYRAVE</b>			<b>1,719,340.72</b>	<b>1,715,692.42</b>
<b>SHPENZIMET OPERATIVE</b>				
SHPENZ. E PAGAVE			612,065.76	714,878.44
SHPENZ. E KEMIKALIEVE			35,716.39	26,542.40
SHPENZ. E REKLAMAVE			3,373.01	4,175.43
SHPENZ E DERIVATEVEVE			32,931.85	41,346.34
SHPENZ E ADMINISTRATES			6,242.27	6,806.44
SHPENZ E MIRMBAJTJES			74,585.59	72,923.90
SHPENZ E ENERGJIS			121,126.62	129,407.93
SHPENZ E BORXHIT TE KEQ			405,731.41	280,511.12
SHP. TJERA OPERATIVE			129,462.10	117,332.69
<b>TOTAL SHPENZ OPERATIVE</b>			<b>1,421,235.00</b>	<b>1,393,924.69</b>
<b>FITIMI OPERATIV PARA ZHVLEFTSIMIT TE MJETEVE</b>			<b>298,105.72</b>	<b>321,767.73</b>
<b>ZHVLEFTSIMI I MJETEVE TE PUNES</b>				
SHPENZ. E ZHVLER INVENTARI,PAIMET,MAKINAT			320,811.69	310,990.56
SHP. E ZHVL.NDERTESSES DHE STR, NDERTIMORE			363,365.20	363,365.21
<b>GJITHESEJT ZHVLEFTSIMII MJETEVE</b>			<b>684,176.89</b>	<b>674,355.77</b>
<b>FITIMI OPERATIV PAS ZHVLEFTSIMIT TE MJETEVE</b>			<b>(386,071.17)</b>	<b>(352,588.04)</b>
<b>FITI (HUMBJA) E VITIT</b>			<b>(386,071.17)</b>	<b>(352,588.04)</b>

- ✓ *Si rezultat I përpjekjeve për zbulimit të keq përdoruesëve të ujit dhe legalizimin e kyçjeve të egra si dhe zgjerimin e zones së shërbimit, kompania krahasuar me vitin paraprak ka rritur të hyrat nga shitjet e ujit për 1.15%.*

*Rezultatin e aritur financiar, nuk e zbehin as rritja e pagave për 16.8% (përmes nivelizimit), e as ngritja e çmimeve të furnizimeve.*

### **3.1.1.Raporti I të Hyrave, Shpenzimeve, të vitit 2011 me ato të planifikuara të 2011**

	<i>Realizuar 2011</i>	<i>Planifikuar 2011</i>	<i>R / P %</i>
<i>Të hyrat nga uji</i>	<i>1.415.161</i>	<i>1,872,020</i>	<i>75.60 %</i>
<i>Të Hyrat nga shërbimet tjera</i>	<i>141.693</i>	<i>156,000</i>	<i>90.83 %</i>
<i>Shpenzimet operative</i>	<i>1.113.378</i>	<i>1,231,590</i>	<i>90.40 %</i>

*Realizimi më I ulët I të hyrave dhe shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara është kryesisht rezultat I pamundësis se marrjes ne menaxhim te ujës-jellësave rural*

### 3.2. Bilanci I gjendjes

BILANCI I GJENDJES 2011.

	Periudha paraprake	Periudha Raportuse
	2010	2011
<b>MJETET-ASETET</b>		
<b>PASURIT QARKULLUSE</b>		
Arka dhe xhirrologaria	89233.76	147345.68
Llogarit e arktushme dhe kërkesat tjera neto	2218611.59	2343217.98
Stoqet neto	3842.03	2724.85
Parapagimet	2027.36	1987.26
Kërkesat nga punëtorët		14671.11
<b>TOTALI I PASURISE QARKULLUSE</b>	<b>2,313,714.74</b>	<b>2,509,946.88</b>
<b>PASURIT JOQARKULLUSE</b>		
Investimet në vijim	216007.89	352215
Toka	1902000	1902000
Objektet ndertimore	7267304.06	7267304.06
Inventari paimet dhe makinerit	1,542,578.64	1,554,952.93
Amortizimi i akumuluar (grumbulluar)	-2095769.04	-2770124.81
<b>TOTALI I PASURIVE JO QARKULLUSE</b>	<b>8,832,121.55</b>	<b>8,306,347.18</b>
<b>TOTALI I MJETEVE</b>	<b>11,145,836.29</b>	<b>10,816,294.06</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>DETYRIMET QARKULLUSE</b>		
Llogarit e pagushme	433624.36	418051.93
Detyrimet ndaj pagave	5911.57	0
Detyrimet ndaj sindikates	5287.97	6679.33
Detyrimet ndaj ATK-se	472103.56	498469.49
<b>TOTALI I DETYRIMEVEQARKULLUESE</b>	<b>916927.46</b>	<b>923200.75</b>
<b>DETYRIMET JO QARKULLUESE (TE HYRAT E SHTYRA)</b>	<b>2734906.23</b>	<b>2751678.75</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>3651833.69</b>	<b>3674879.5</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>		
<b>EKUITETI</b>		
Kapitali dhe rezervet	8287522.81	8287522.81
Fitimet (humbja) e akumuluar (deri 2010 dhe 2011)	-407449.04	-793520.21
Fitimi (humbja) e vitit (2010 dhe 2011)	-386071.17	-352588.04
<b>TOTALI I EKUITETIT</b>	<b>7494002.6</b>	<b>7141414.56</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEV DHE KAPITALI</b>	<b>11,145,836.29</b>	<b>10,816,294.06</b>

Fundviti 2011 e gjen kompaninë me një shtim të kapitalit qarkullues prej 8.48% kryesisht si rezultat i grumbullimit të mjeteve të gatshme përmes pagimit të kushtëzuar të ujit nga konsumatorët.

Janë rritur edhe investimet në vijim, e që kanë të bëjnë me ndërtimin e objektit administrative, i cili është në përfundim e sipër.

Shifet edhe një zbritje e vogël e borxhit ndaj furnitorëve. Obligimi ndaj ATKsë I paraqitur në bilancin e gjendjes është TVSh-në e kalkuluar, dhe obligim që do të krijohet vetëm po t ë inkasohet tërësisht faturimi. Edhe ATKja qëndron pas faktit se TVSh-ja të paguhet në mjetet e inkasuara e jo nga faturimi.

### 3.3.Pasqyra e rrjedhës së parashë

PASQYRA E RRJEDHEJES SE PARASE		Periudha paraprake		Periudha raportuse	
		2010		2011	
<b>I. AKTIVITETI OPERATIVE</b>					
<b>HYRJET</b>			<b>1,363,895.04</b>		<b>1,417,616.19</b>
1	INKASIMET NGA SHITJET -SHERBIMET	1,560,026.56		1,556,853.63	
2	ILLOGARIT E ARKETUSHME RRITJE(1914316.14-1794426.64	(119,889.50)		(141,126.44)	
3	KERKESAT AFAT SHKURTA LLOG. TJERA TE ARKET.(304295.45-230080.79	(74,214.66)			
4	PARAPAGIMET	(2,027.36)		40.1	
5	KERESAT NGA PUNTORËT			1848.9	
<b>TOTALI I HYRJEVE NGA AKTIV. OPERATIV</b>		<b>1,363,895.04</b>		<b>1,417,616.19</b>	
<b>DALJET</b>			<b>1310480.85</b>		<b>1,369,761.90</b>
6	KMSH	-		346.74	
7	STOQET	(8,705.42)		-1117.18	
8	LLOGARIT E PAGUSHME	17,960.56		15572.43	
9	PAGAT	612,065.76		714878.44	
10	TATIMI I PAGUSHEM	(67,856.57)		-26365.93	
11	SHPENZ. E ADMINISTRATES	19,915.19		18800.97	
12	SHPENZ. E RRYMES	121,126.62		129407.93	
13	SHPENZ. E MIRMBAJTEJES	74,585.59		72923.9	
14	SHPENZ. E TJERA OPERATIVE	187,810.43		177055.79	
15	SHPENZ. E BORGJIT TE KEQE	405,731.41		280511.12	
16	SHPENZ. AKRUALE DHE AVANSET E MARRUNA	(52,152.72)		-12252.31	
<b>TOTALI I DALJEVE NGA AKTIVITETI OPERATIV</b>		<b>1,310,480.85</b>		<b>1,369,761.90</b>	
<b>PARAT NETO NGA AKTIVITETI OPERATIV</b>		<b>53,414.19</b>	<b>53,414.19</b>	<b>47,854.29</b>	<b>47,854.29</b>
<b>II. AKTIVITETET INVESTUSE</b>					
17	SHITJA E ASETETEVE	6,000.00			
18	BLERJA E ASETETEVE	(151,513.97)		-148581.4	
19	INKASIMI NGA INTERESI			776.74	
<b>PARAT NETO NGA AKTIVITETI INVESTUS</b>		<b>(145,513.97)</b>	<b>(145,513.97)</b>	<b>(147,804.66)</b>	<b>(147,804.66)</b>
<b>III. AKTIVITETET FINANSUESE</b>					
20	DETYRIMET AFAT SHKURTA	159314.16		158062.05	
21	HUAT AFAT SHKURTA	0		0	
<b>PARAT NETO NGA AKTIVITETI FINANSUES</b>		<b>159,314.16</b>	<b>159,314.16</b>	<b>158062.05</b>	<b>158062.05</b>
22	RRJEDHA E ARKES GJATE VITIT		67,214.38		58,111.68
23	PARAT NE ARKE DHE BANKE NE FILLIM TE PERIUDHES		22,019.38		89,234
24	PARAT NE ARKE DHENE BANKE NE FUND TE PERIUDHES	-	89,233.76		147,345.68

### 3.4. Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet

#### PASQYRA E NDRIMIT TE EKUITETIT ME 31.12.2011

	Kapitali Akcionar	Rezervat Kapitale	Fitimet (Humbja) e akumuluar	Total Ek.pas humb.
Bilanci me 01.01.2010	25,000.00	8,262,522.81	(407,449.04)	7,880,073.77
Fitmi/Humbja e vitit			(386,071.17)	(386,071.17)
Me 31.12.2010	25,000.00	8,262,522.81	(793,520.21)	7,494,002.60
Bilanci me 01.01.2011	25,000.00	8,262,522.81	(793,520.21)	7,494,002.60
Fitmi/Humbja e vitit			(352,588.04)	(352,588.04)
Me 31.12.2011	25,000.00	8,262,522.81	(1,146,108.25)	7,141,414.56

Pasqyra e ekuitetit tregon se kompania po afaron nën nivelin e riprodhimit të thjeshtë. Edhe pse rezultati operativ (para zhvleftësimit) i kompanisë është pozitiv, kjo nuk po mjafton të mbulojë tërësisht zhvleftësimin e mjeteve. Për vitin 2011 fitimi operativ ishte 321.803 € ndërsa zhvleftësimi i mjeteve ishte 674.356€, pra kompania është në humbje (zvoglim të kapitalit) për 352.553 € meqë për kaqë nuk po mbulohen zhvleftësimi i mjeteve.

### 4. PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT

#### 4.1. Pasqyre e progresit ne implementimin e planit te biznesit

tabela e treguesëve krahasues dhe e performancës

	Realizuar 2010	Planifikuar 2011	Realizuar 2011	2011R/2010R	2011R/2011P
Prodhimi I ujit m3	7,462,790	7,543,000	<b>7,181,811</b>	96.23%	95.21%
Faturimi I ujit m3	2,979,490	3.399.000	<b>2,930,109</b>	98.34%	86.21%
Faturimi në €	1,399,474	1,872,020	<b>1,415,161</b>	101.12%	75.60%
Arketimi në €	949,170	1,264,280	<b>1,105,165</b>	116.43%	87.41%
Arketimi nga shërbimet tjera në €	88,586	156,000	<b>81,124</b>	91.58%	52.00%
Total arketimi	<b>1,037,756</b>	<b>1,420,280</b>	<b>1,186,289</b>	114.31%	83.53%
Shpenzimet	1.015.504	1,231,590	<b>1,113.378</b>	109.64%	90.40%
Numri I konsumatorëve	18.200	21.080	<b>19.110</b>	105%	90.65%
Konsumatorët me ujëmatës	14.699	18.700	<b>15.607</b>	106.18%	83.46%

**Prodhimi i ujit m<sup>3</sup>**

Prodhimi i ujit gjatë vitit 2011, ka qenë në suaza të kërkesave dhe të planifikimit. Janë prodhuar 3.77% m<sup>3</sup> ujë me tepër se vitin paraprakë, dhe 4.79% më pak se që ka qenë planifikuar të prodhohen gjatë 2011.

**Faturimi i ujit në m<sup>3</sup>:**

Krahasuar me vitin 2010, gjatë 2011 janë faturuar 1.66% m<sup>3</sup> ujë më pak, ndërsa krahasuar me faturimin e planifikuar del se faturimi është më i ulët për 13.79%.

**Faturimi i ujit në €:**

Faturimi në vlerë monetare, gjatë vitit 2011 ka tejkaluar atë të vitit 2010 për 1.12%, ndërsa krahasuar me faturimin e planifikuar për 2011, faturimi ka qenë më i ulët për 24.40%.

**Arkëtimi €**

Arkëtimi i vitit 2011 ka qenë mjaft i suksesshëm, ka tejkalua arkëtimin e vitit paraprak për 16.43% ndërsa krahasuar me planifikimin e vitit 2011ka qenë më e ulët për 12.59%.

**Shpenzimet në €**

Shpenzimet e vitit 2011 ishin më të larta se ato të vitit 2010 për 9.64%, ndërsa në raport me planifikimin janë më të vogla për 9.6%

**Përqindja e arkëtimimit sipas viteve:**

	2010	2011	2011
		Aktual	Plani
% e arkëtimimit	67.82 %	78.09 %	68.00 %

Shkalla e arkëtimimit gjatë vitit 2011, ka qenë më e suksesshme se e vitit paraprak, por edhe ka tejkalua parashikimet e planifikuara për 10.09%.Kjo rritje është si rezultat i aplikimit te formës se kushtëzimit me pagese te ujit, ne kryerjen e disa shërbimeve komunale.

**Totali i konsumatorëve**

Numri i konsumatorëve është shtuar gjatë vitit 2011 për 5% në krahasim me vitin paraprak, por ngecë nga numri i planifikuar për 9.35%.

**Numri i konsumatorëve me ujëmatës**

Numri i konsumatorëve me ujëmatës është rritur për 6.18% në krahasim me vitin 2010, por është më i vogël për 16% në raport me të planifikuarit.



#### **4.2.Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe të strategjive**

*Nga treguesit e arritur të performancës së vitit 2011, konkludoim se, kompania "Hidromorava" ka arritur performancë pozitive krahasuar me vitin paraprak 2010. Realizimi i objektivave dhe strategjive të synuara të kompanisë po janë gjithnjë e më të mira për vite, çka tregon se kompania po konsolidon gjithnjë e më tepër shërbimet dhe afarizmin e vet.*

*Krahasuar me vitin paraprak 2010, treguesit e performancës janë tejkaluar dukshëm, madje disa prej tyre edhe për 16.43 %.*

*Mirëpo, realizimi i parametrave të planifikuara oscilon nga 84% - 95% dhe kjo kryesisht nga pamundësia e marrjes në Menaxhim të të gjitha sistemeve të planifikuara të ujësjellësve rural dhe atë për shkak se: shumica e këtyre sistemeve, teknikisht nuk janë përfunduar, në disa prej tyre janë instaluar material i dobët i kyçjeve individuale, apo, nuk janë bërë kyçjet e tërësishme individuale, problemet e tyre me borxhet e stër ngarkuara me rrymë elektrike.*

*Para se të mirren nën menaxhimin e "Hidromoravës" sistemet rurale të ujësjellësve më pare do duhej ti evitojn defektet e cekura në sistem, të gjindet forma e shlyrjes së obligimeve të rrymës ndaj KEKut, te instalohen ujematesit te të gjithë konsumatorët. Kjo për atë se me gjendjen e tashme të tyre, "Hidromorava" e ka shumë vështirë ti marr në menaxhim.*

*Për të funksionua më mire ndërtimi i sistemeve të ardhshme rurale dhe kyçja e tyre nën menaxhimin e "Hidromoravës", do duhej një koordinim më funksional mes Donatorëve, Pushtetit lokal dhe Kompanisë. Menaxhmenti i kompanisë ka bërë hapa konkret në këtë drejtim, duke parashtruar këtë problem në kontaktet me donatorët dhe Organet e Pushtetit Lokal, dhe janë marrë qëndrime pozitive për koordinim të përbashkët të punëve të këtyre qështjeve.*

*Si rezultat i realizimit të qëndrimeve të tilla, e në bashkpunim me NjPMNP gjithashtu, është vendosur që të formohet një komision i përbërë nga një përfaqësues i kompanisë "Hidromorava" dhe nga drejtorët e shërbimeve publike të këtyre komunave, dhe të bëhet vlerësimi i gjendjes egzistuese të këtyre sistemeve, dhe tu dërgohet një raport NjPMNP në mënyrë që kjo pastaj ta prezantoj atë tek donatori Zvicran për ndihmë në riaftësimin e këtyre sistemeve.*

#### **4.3.Ndryshimet që janë paraqitur gjatë aktiviteteve, operimeve, dhe ambientit që e rrethon ndermarrjen që nga përgatitja e planit të biznesit. Ndikimi i tyre në arritjen e objektivave të planit të biznesit**

*Rezultatet e konsolidimit gjithnjë e më të mirë të kompanisë, po ndikoin pozitivisht edhe në disponimin dhe motivimin e punëtorëve për punë dhe marrëdhanje të mira kolegjiale.*

*Kushtëzimi i pagesës së ujit, i mbështetur dhe aplikuar nga Organet e Pushtetit Lokal, përveç tjerash, i ka mundësua Menaxhmentit të kompanisë shfrytëzimin më efektiv të resurseve të veta njerëzore.*

Përmes organizimit të ekipeve shtesë për identifikimin dhe legalizimin e kyçjeve ilegale, të instalimit të ujëmatësve, ekipeve shtesë për lexim të ujëmatësve, ekipe shtesë të formuara kryesisht nga inkasantët (tani më pak të nevojshëm për angazhim në inkasim), menaxhmenti i kompanisë synon të përmirësoj edhe më tej performancën e kompanisë në zvoglimin e humbjeve të ujit të prodhuar, gjegjësisht ujit të pa faturuar e me këtë edhe në rritjen e të hyrave të kompanisë, si bazë themelore e krijimit të mundësive financiare të vetqëndrueshmërisë dhe të investimeve kapitale me mjete vetanake.

Realizimi i dinamikës së planifikuar i sistemeve të ujësjellësve rural, do të ndikojë në masë edhe në realizimin e parametrave të planifikuara të kompanisë gjithashtu.

## 5. SHPENZIMET KAPITALE DHE TË PROJEKTEVE

### 5.1. Investime kapitale dhe aktivitetet tjera operative

Gjatë vitit 2011 janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e ujësjellësit në Gjilan dhe në dy njësit operative Viti dhe Kamenicë si nga ana e kompanisë ashtu edhe nga ana e komunave.

Në kuadër të përmirësimit të furnizimit të qytetarëve me ujë, Kompania ka bërë disa investime në rrjetin e ujësjellësit sidomos në zgjerimin e zonës së shërbimit dhe në rritjen e presioneve në rrjetin e ujësjellësit.

Në vazhdim po paraqesim investimet e realizuara nga ana e kompanisë, që kanë të bëjnë me zgjerimin e zonës së shërbimit dhe me rritjen e presionit në rrjetin e ujësjellësit.

Nr.	Përshkrimi i aktiviteteve kryesore	Koha e përfundimit të aktivitetit
1	Kyaja e kompleksit banesor dhe e ambulantes QKMF në rrjetin kryesor në rrjetin e ujësjellësit	TM-1
2	Vendosja e dy hidranteve për nevoja zjarrfikje në dy lokacione, fakulteti i edukimit dhe afër objektit të zjarrfiksave.	TM-1
3	Ndertimi i rrjetit në rrugën Sadik Sadiku, DN 63mm PE, L=85 m'	TM-2
4	Ndertimi i rrjetit në rrugën e Bujanocit, DN 63mm PE, L=50 m'	TM-2
5	Ndertimi i rrjetit në rrugën Ramiz Sadiku, DN 63mm PE, L=40 m'	TM-2
6	Ndertimi i rrjetit në rrugën XVI Dardania II, DN 160mm PE, L=300 m', Kompania ka kontribuar me montimin e kyçjeve individuale.	TM-2
7	Ndertimi i rrjetit- dislokimi i gypit PE nga parcela ku planifikohet ndertimi i objektit për aftësim profesional, DN 63mm PE, L=~90 m'	TM-3
8	Ndertimi i rrjetit- dislokimi i gypit PE nga parcela ku planifikohet ndertimi i objektit banesor nga kompania DIAMOND Gjilan, DN 63mm PE, L=~90 m'	TM-3
7	Dislokimi i gypit për shkak të ndertimit të shkolles së Mesme të Bujqësisë. Gypi DN 63 mm, L= 90m'	TM-4

8	Leshimi i pompes zhytuese ne pusin e ujesjellesit ne fshatin Malisheve per 15 thellesi, per shkak te paraqitjes se mungeses se ujit ne pus.	TM-4
9	Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit ne rrugen "Beqir Musliu" ne rrugen X. Eshte ber nje dalje nga gypi DN 100mm AC ne DN 63mm PE.	TM-4
10	Zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit ne rrugen "Vllezrit Llozana" ne rrugen X. Profili i gypit DN 32mm, L=90m'	TM-4
11	Ndrrimi i ventilit te ajrit me nje te ri DN 80mm ne rrugen "Gjon Sereqi" Gjilan	TM-4

### 5.2. Gjatë periudhës raportuese janë bërë edhe disa aktivitete të tjera si:

- a. evitimi i defekteve në rrjet të ujësjellësit,
- Janë evituar 331 defekte-rrjedhje në tubacionet nën DN 63mm.
  - Janë evituar 173 defekte-rrjedhje në tubacionet nga DN 63mm deri në DN 160mm.
  - Janë evituar 47 defekte-rrjedhje në tubacionet nga DN 160mm deri në 400 mm.
  - Janë zbuluar apo identifikuar mbi 300 konsumatorë të ri, shumica janë regjistruar ndërsa pjesa tjetër janë në procedurë të legalizimit- regjistrimit.
- b. montimi i ujëmatësve për të gjithë kategoritë e konsumatorëve.
- 1381 ujëmatës të profileve 1/2"- 3/4", për kategorinë e amvisërisë dhe bizneseve të vogla,
  - 7 ujëmatës të profilit 1", për kategorinë e bizneseve ,
  - 7 ujëmatës të profilit 5/4" për kategorinë e institucioneve dhe bizneseve,
  - 8 ujëmatës të profilit 6/4" për kategorinë e institucioneve dhe bizneseve,
  - 5 ujëmatës të profilit DN 50mm, për kategorinë e institucioneve, bizneseve dhe banesave kolektive.
  - 11 ujëmatës të profilit DN 80mm, për kategorinë e institucioneve, bizneseve të mëdha dhe banesave kolektive.

### 5.3. Progresi i projekteve kapitale dhe aktiviteteve tjera operative të kompanisë

Ndërtimi i objektit të administratës, si projekt kapital i kompanisë i financuar nga Grantet Qeveritare të Republikës së Kosovës, është në përfundim e sipër. Kanë mbetë të kryhen punët finale në te, për të cilat do të nevojiten mjete shtesë (të parapara).

Zvaritjet në përfundimin e tijë kanë qenë kryesisht pasojë e planit jo gjithëpërfshirës të tijë, me pasoja të shtimit të punëve shtesë.

Investime tjera kapitale në kompani nuk ka pasur gjat vitit 2011, përveq aktiviteteve operative të kompanisë në mirëmbajtjen dhe riparimin e rrjeteve të sistemit të ujësjellësve. Angazhimet e tilla nuk kanë qenë të pakta, duke marrë parasyshë nevojën e riparimeve të shpeshta në rrjetet e stërvetruata të sistemit të ujësjellësve, nevojën e zgjerimeve të rrjeteve, si dhe me domosdoshmëritë e modifikimeve të rrjeteve si pasojë e ndryshimeve në ndërtimin e objekteve të reja.

## 6. PERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHEM

---

### 6.1. Skica gjithëpërshirëse e planit të biznesit për vitin e ardhshëm dhe identifikimi objektivave kryesore

Plani i Biznesit definon qartë orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe definon qartë objektivat dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.

Plani është përgatitur duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë për të adoptuar praktikatat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë. Por gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në Republikën e Kosovës.

Plani i Biznesit 2012-2014 definon qartë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojë me një arritje të vetë qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat financiar dhe operativ janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave – uljen e tyre) pa e dëmtuar funksionimin dhe ofrimin sa më cilësor të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të jenë sa më afër realitetit dhe parametra të arritshëm.

Ky plan merr parasysh të gjithë faktorët dhe rrethinën që kanë ndikim në punën e Kompanisë. Plani i Biznesi i hartuar merr parasysh strategjinë zhvillimore të regjionit, njëkohësisht duke marrë parasysh edhe direktivat evropiane për ujin e pijes dhe ujërat e zeza.

Plani i Biznesit është i orientuar fuqishëm në drejtim të mundësive vetanake financiare dhe Donatorëve ku realizimi i këtij plani, e sidomos i Planit të investimeve kapitale është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga Donatorët, institucionet qendrore dhe lokale.

Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky Plan, në mënyrë që Kompania të arrijë një qëndrueshmëri financiare që të ofrojë shërbime cilësore për konsumatorët.

### 6.2. Objektivat strategjike të KRU "Hidromorava" sh.a.

Plani i Biznesit përfshinë synimet afariste të Kompanisë gjatë periudhës 2012–2014 dhe përveç të tjerash, vlerësohet se do të përmirësojë kontrollin menaxherial mbi kompaninë dhe shmangien ndaj gabimeve që mund të e sjellin atë në dështim të përbushjes së standardeve të shërbimeve. Plani i biznesit do të nënshtrohet rishikimit dhe freskimit së paku në baza vjetore.

Zona e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga KRU "Hidromorava" Sh.A. vlerësohet të ketë rreth 172,500 banorë dhe furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e mbulimit me shërbime aktualisht është **77%**. Synohet që gjërat të mbarojnë në vitin 2014 KRU "Hidromorava" Sh.A. të zgjerojë zonën e mbulimit me shërbime në **89%**.

Gjatë kësaj periudhe, KRU "Hidromorava" planifikon të përmirësojë furnizimin me ujë të pijshëm për konsumatorët ekzistues dhe ata të rinj në 23.30 orë të kontinuitetit të furnizimit.

Krahas përmirësimit të shërbimeve të ofruara, KRU "Hidromorava" Sh.A. synon që gjatë kësaj periudhe të përmirësojë afarizmin ekonomik dhe atë:

- (1) duke shtuar përpjekjet në ngritjen e shkallës së arkëtimit në 78.58 % në vitin 2012, e cila në vitin aktual 2011 është 78.00 %, dhe

(II) duke shtuar masat e kontrollit të ujit të prodhuar i cili iu shpërndahet konsumatorëve dhe me këtë të ndikoj ne zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit, gjegjësisht të ujit i cili nuk faturohet dhe nuk i sjell Kompanisë të ardhura/përkundrazi vetëm sa i shton shpenzimet operative/. Uji i pafaturuar, ne vitin 2012 pritet të ulet në 55% e i cili ne vitin aktual 2011 është 60%.

Realizimi i këtyre synimeve do ti mundëson kompanisë gjenerimin e te ardhurave të mjaftueshme për te qene “ vetfinancues i qëndrueshëm” dhe do te rrisë aftësinë financiare te kompanisë për mbulimin e pjesërishëm te investimeve te parapara për periudhën planifikuese.

Konrolli dhe evitimi i humbjeve teknike dhe komerciale, si dhe me shtimin e mbikëqyrjes se shpenzimeve te përgjithshme te Kompanisë, planifikohet një zvogëlim i shpenzimeve operative.

Krahas ngritjes teknike te kapaciteteve te Kompanisë, rendësi e veçante do ti kushtohet ngritjes se aftësive profesionale te stafit, dhe për këtë menaxhmenti do identifikoj lëmit adekuate për trajnim te stafi. Menaxhmenti i Lartë i Kompanisë i pranon përgjegjësitë e saja ndaj të punësuarve të tjerë dhe do të zhvillojë e zbatojë politika që do të ndihmojnë stafin në arritjen e objektivave dhe synimeve të vëna. Kompania edhe më tutje do të avancoj sistemin ekzistues informativ të menaxhmentit.

**Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike, deri në vitin 2014 Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike në vijim:**

- Rritjen e kontinuitetit të furnizimit me ujë të pijshëm në 23.30 orë.
- Rritjen e proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës në 99%

**Treguesit e përformancës sipas viteve**

➤ Treguesit	2011	2012	2013	2014
➤ Uji i pa faturuar	60%	55%	53%	51%
➤ Shkallës së arkëtimit	78.00	78.58%	78.33%	79.25 %
➤ Shpenzimeve për njësi prodhimi	0.15	0.13	0.15	0.15 €
➤ Normës së mbulesës së punës	1.29	1.66	1.37	1.31
➤ Rritjen e efikasitetit të stafit	8.45	7.79	7.67	7.45
➤ Nr. i konsumatorëve	17,985	19,508	19,806	20.401
➤ Nt. i konsumatorëve me ujëmatës	15,318	17,868	18,531	19,743

## **7. RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATËS**

### **7.1. Cilat janë rreziqet kryesore të cilat ndërmarrja do të ballafaqohet gjatë dy viteve të ardhshme?**

Rreziqet kryesore me të cilat do të ballafaqohet kompania në dy vitet e ardhshme do të jenë:

1. Reshjet e mëdha të bores
2. Shkalla e ulët e arkëtimit,
3. Rritja e kostos së jetesës. (Inflacioni)

Per shkak të reshjeve të mëdha të bores dhe mundësisë së shkrirjes së shpejtë me rritjen e temperaturave, ekziston rreziku i prurjeve të mëdha të ujit në akumulacion, dhe me këtë edhe kapërderdhje të ujit në liqenin e Perlepnices. Mos përfundimi i objektit të kapërderdhjes edhe me tutje mund të jetë rrezik permanent për stabilitetin e trupit të Pendës për shkak të erodimit të trupit të Pendës. Në rast të vershimeve të mundshme për shkak të shkrirjes së bores por edhe të reshurave të mundshme të shiut mund të rrezikohet edhe kualiteti i ujit në burime sidomos në burimet sipëfaqësore por edhe ato nëntoksore.

Këtë rrezik mund të nënshtrohen gati të gjitha burimet që i disponon KRU Hidromorava duke përfshirë edhe dy komunat Viti dhe Kamenice.

Shkalla e inkasimit në dy vitet e ardhshme pritet të jetë e ulët për shkak se kompania që nga muaji shkurt i vitit 2012 i ka tërhequr inkasantët nga terreni. Inkasimi i borxheve të konsumatorëve nuk do të bëhet më nga inkasantët si më parë, ku pagesën e obligimeve ndaj kompanisë konsumatorët e bënin në shtëpi me para në dorë të inkasantët. Kjo tërheqje e inkasantëve nga terreni është bërë me qëllim që të shmangemi parregullsi eventuale gjatë pagesave, shfrytëzimit me efektiv të punëtorëve, largimit të formës së pagesave me paranë dorë-, si dhe kalimin e pagesave në arkat e kompanisë dhe përmes bankave ( llogarive bankare).

Rrezik do të jetë edhe rritja e kostos jetësore të konsumatorëve, si shkak i rritjes së çmimeve-inflacionit, për këtë do të kemi vështirësi në arkëtimin e borxheve të konsumatorëve të cilëve do ju rriten shpenzimet jetësore, e që do të ndikojnë në kryerjen e detyrimeve ndaj kompanisë për shërbimet e pranuar.

### **7.2. Çfarë duhet të bëhet për të ulur ndikimin e secilit rrezik?**

**7.2.1. Objekti i kapërderdhjes në Perlepnice edhe pse e filluar të ndërtohet në vitin 1998 qysh nga ajo kohë ende nuk është përfunduar. Arsyeja e mos përfundimit të këtij projekti është situata e paraqitur në atë kohë dhe ndërprerja e investimit për shkak të luftës në Kosovë.**

Rreziku i mospërfundimit të kapërderdhjes është i madhë kur dihet se objekti është vazhdimësi e trupit të Pendës dhe qdo erodim i tokës në afërsi të trupit të Pendës është rrezik i drejtpërdret i stabilitetit të vet trupit të Pendës.

Që nga vitet 1999 e deri me tani nga pellgu i lumit Perlepnica i cili e ushqen akumulacionin e Perlepnices disa herë ka pasë prurje të mëdha të ujit që detyrimisht është dashtë që uji të kalojë përmes kapërderdhjes së pa përfunduar. Sasia e madhe e ujit ka shkaktuar dëme të mëdha në konstruksionin e kapërderdhjes dhe për këtë arsye profili ku planifikohet të vazhdohet ndërtimi i kapërderdhjes ka ndërruar shumë në krahasim me gjendjen e fillestare.

KRU "Hidromorava" Sh.a, e cila menaxhon me këtë objekt disa herë ka ngritë këtë shqetësim për sa i përket këtij problemi dhe vazhdimisht kemi kërkuar që të përfundohet ky objekt me rëndësi të veçantë, por për fat të keq deri më tani nuk kemi gjetë një përkrahje financiare qoftë nga donatorët apo strukturat e tjera qeveritare.

Ne konsiderojmë se vazhdimi i kësaj gjendje është shumë e rrezikshme dhe mund të atakoj edhe jeten e një pjese të konsiderueshme të banorve sidomos të fshatit Perlepnice i cili shtrihet në kilometrin e parë nën akumulacionin e Perlepnices.

Rreziku mund të jete edhe me i madhe kur aktualisht kemi sasi shume te madhe te bores ne pellgun e akumulacionit Perlepnica dhe nje shkrirje e shpejte munde te sjelle situata te paperballueshme si per Kompanin ashtu edhe per komunën e Gjilanit.

Prandaj, permes kesaj shkrese kerkojme nga Ju qe te beni te pamunderen qe ky investim te realizohet ne menyre qe te ruhet stabiliteti i trupit te pendes e me kete edhe jeta e banoreve.

Poashtu rrezik tjetër mund të jete edhe veshtiresia e trajtimit te ujit ne liqenin e Perlepnices nese prurjet e medha mund te shkaktojne turbullire shume te madhe te ujit qe pamundeson nje trajtim konstant te tije. KRU Hidromorava duhet te veshtroje situaten me kujdes dhe ne bashkepunim edhe me strukturat te tjera komunale ti marin masat e duhura per evitimin e ketyre rreziqeve.

**7.2.2.Për rrezikun e uljes se shkallës së arkëtimit për vitet e ardhshme kompania do të ndërmerr veprimet të cilat e ndihmojnë ngritjen e arkëtimit si:**

- Të gjithë inkasantët të cilët kanë bërë inkasimin e pagesave në teren i ka angazhuar në leximin e ujëmatësve si dhe në ekipe për shkycje .

Ky aktivitet do te na mundësoje qe ta freskojmë bazën e te dhënave te konsumatorëve si dhe do te mundësoj qe konsumatori te paguaj sipas harxhimit .Leximi tash do te behet ç' do te dytin muaj dhe konsumatori do te jete ma i kënaqur me shërbimet tona,ne këtë mënyre edhe gatishmëria e konsumatorëve për pagesë do te jete me e madhe. Edhe ekipi i shkycjen do te jete vazhdimisht i angazhuar ne teren për konsumatorëve të cilët nuk i kryejnë detyrimet për shërbimet e pranuar, gjithherë duke ju referuar rregulloreve të ZRRUM-it.


Brenda kësaj kohe konsumatorëve ju kemi mundësuar që pagesat e tyre ti bëjnë në arkat ndihmese të kompanisë të cilat i kemi hapur në teren edhe atë katër arka në pika të ndryshme të qytetit.

Po ashtu për lehtësimin e pagesave ndaj kompanisë konsumatorëve do t'ju ofrojmë edhe mundësin e pagesave për mesë bankës - debiti direk.

**7.2.3.Për rrezikun e trete -rritjen kostos së jetës ne si kompani nuk munde të ndikojmë, por do te atakohemi me ketë problematik e cila ndikon në aftësinë (forcën) e pagesës së konsumatorëve ndaj obligimeve të kompanisë**

**Shtojcë :Formullari i vetvleresimit te Bordit te Drejtoreve**

Kryeshefi Ekzekutiv



Myrvete Hoti



Kryesuesi i Bordit te Drejtoreve



Avdyl Hasani